

(Çështë poezia)

Rima e puthur (AABB)

do të tretem, të **kullohem**, **A**
 të digjem, të **përvëlohem**, **A**
 që t'u ndrinj mir' e të **shihni**, **B**
 njëri-tjatërin të **njihni**. **B**

('Fjalët e qiririt', N.Frashëri)

Rima e kryqëzuar(ABAB)

Gurra e lugut veç **ushtonte** **A**
 si lahutë me kangë **kreshnike**; **B**
 e ndër pemë bylyli **këndonte** **A**
 valle dasmet e **fisnike**. **B**

('Andrra e jetës (Trina)', N.Mjeda)

1.Shërbehu nga shembujt,dhe vendos shkronja A dhe B në poezi,që të përcaktosh rimat në poezi.

Dritat shumëngjyrëshe shkëlqyen

n'mësonjëtoresh shqipe u përziën

Pandeli Sotiri,mësues i shquar

mësonjëtoresh shqipe e ka lulëzuar.

2.Shërbehu nga shembujt dhe vendos shkronja A dhe B në poezi.

Po del dimni me kosë n'dorë,

Gjeth'e bar i ka kositë,

Qet'ballkoni pjalm e borë

E plak-shkreti tui mërdhitë,

I thotë vedit me za pak:

– Struku, struku, i shkreti plak!

Me sukses

Me vështirësi

Më ndihmën e mësimdhënësit

Kontrolloi _____

Prindi _____